REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës:	2023:073149
Datë:	23.10.2023
Numri i dokumentit:	04816676

SCC – 08 – 0232

Paditësit – propozuesit e sigurimit:

M, N nga R, dhe M K nga R, N K nga Nishi, dhe S N nga Ruma, që të gjithë nga Republika e Serbisë e të cilët me autorizim, i përfaqëson, av. D L nga Graçanica.

Kundër :

E paditura - kundërshtarja e sigurimit:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr.''Dritan Hoxha'', nr.55, Lagjja, ''Lakrishtë'' Prishtinë.

Ndërhyrësi kryesor: H B nga Fushë Kosova e të cilin me autorizim i përfaqëson,av. J F nga Graçanica.

Për : Palët.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), me Kolegjin në përbërje nga gjykatësi, Agron J. Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatëses, Diellza Hoxha, dhe gjykatësit, Shkelzen Sylaj, pas seancës vendimmarrëse, të mbajtur me **dt.23.10.2023**, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pabazuar propozimi i paditësve – propozuesve të sigurimit, M, N nga Ruma, dhe M K nga Ruma, N K nga Nishi, dhe S N nga Ruma, që të gjithë nga Republika e Serbisë për caktimin e masës së sigurimit.

II. Nuk caktohen taksat tjera gjyqësore.

2023:073150

Rrethanat procedurale dhe faktike

Paditësit, me dt.18.07.2008, pranë Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kanë paraqitur padinë dhe atë për vërtetimin e pronësisë kunder te paditurave, KBI,''Kosova - Export'', Fushë Kosovë dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, e me të cilën paditësit, kanë kërkuar që të vërtetohet se e njëjtët, janë pronarë të ngastrave dhe atë : ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 1,50,42 ha, ngast.kad.nr… në sipërf, prej 1,74,59 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 1,86,00 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 2,518,80 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 0,29,85 ha, ngast.kad.nr….. në sipërf. prej 0,31,69 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 0,68,00 ha, dhe ngast.kad.nr….. në sipërf. prej 4,50,85 ha, në vendin e quajtur,''.....e evidentuar sipas lp, nr…., ZK Dobrevë e Epërme e që të paditurat janë të detyruara që këtë t'a pranojnë e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësit kësaj padie, ia kanë bashkangjitur si provë: kopjen e listën poseduese të ish Entit Republikan të Gjeodezisë – Komuna e Fushë Kosovës, …..të dt…...

Me dt. 06 gusht 2008, Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), ka lëshuar Urdhrin e saj, SCC -08 - 0232 të dt.06 gusht 2008 e me të cilin i ka urdhruar paditësit që t'ia dorëzojnë evidencën kadastrale për ngast.kad.nr…., ngast.kad.nr…., ngast.kad.nr…, ngast.kad.nr…, ngast.kad.nr…, ngast.kad.nr…, ngast.kad.nr…, dhe ngast.kad.nr…, ZK Dobrevë e Epërme dhe shkresat tjera të dhe se paditësit me parashtresën e dt.10.09.2008, kësaj gjykate ia kanë dorëzuar provat gjegjëse : kopjen e aktvendimit, Nr.04.Nr.464 – 1309/91 të dt.02.02.1992, kopjen e listës poseduese të Drejtorisë së Gjeodezisë së Komunës së Prishtinës, të dt.25.02.1993 për ngastrat e lartëcekura, kopjen e listën poseduese të ish Entit Republikan të Gjeodezisë – Komuna e Fushë Kosovës, Nr…. të dt….., dhe kopjen e aktvendimit, 338/2008 të dt.26.08.2008 të Drejtorisë së Gjeodezisë së Komunës së Fushë Kosovës për refuzimin e kërkesës së paditësit për bartjen e patundshmërive.

Me dt.24.09.2008, paditësit, i janë drejtuar DhPGJSK-së, me parashtresën e dt.10.09.2008 e së cilës ia kanë bashkangjitur, kopjen e kontratës së shitëblerjes së dt.05.08.1994 të lidhur në mes paditësve dhe A Z B nga D e P.

Me dt.24.09.2008, paditësit, i janë drejtuar DhPGJSK-së, me parashtresën e dt.10.09.2008 e së cilës ia kanë bashkangjitur, kopjen e kontratës së shitëblerjes së dt.05.08.1994 të lidhur në mes paditësve dhe A Z B nga D e P, Komuna e Fushë Kosovës.

Me dt.30.03.2022, paditësit, i janë drejtuar kësaj gjykate, me parashtresën e dt.29.03.2022 e përmes së cilës e kanë bërë rregullimin dhe precizimin e padisë së tyre e në të cilën kanë edhe ndryshimin e padisë.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Me dt.30.03.2022, personi i tretë, H B nga Fushë Kosova, i është drejtuar kësaj gjykate me propozimin e tij për ndërhyrje në kontest si dhe ka bërë padi për ndërhyrje në seancë kryesore

2023:073150

e në të cilën në mes tjerash ka kërkuar nga gjykata që të merr aktvendim dhe të lejohet ndërhyrja në kontest e propozuesit, H B nga Fushë Kosova e duke pasur parasysh dëshmitë e deponuara si dhe faktet e pa kontestuara që ndërhyrës i bleu patundshmërinë e cekur që paditësi, M N, atë të dretjë nuk e konteston, andaj ndërhyrësi i ka propozuar gjykatës që pas parashtrimit të dëshmive të nxjerrë aktgjykim e me të cilin aprovohet kërkesëpadia e ndërhyrësit, H B nga Fushë Kosova, dhe vërtetohet se ai është pronar i paluajtshmërisë në ngast.kad.nr…. në vendin e quajtur, ’’ …’’, fushë e klasës së III, në sipërf. prej 1,50,42 ha, dhe ngast.kad.nr…., në vendin e quajtur, ’’Fusha e gjerë’’, fushë e klasës së V, në sipërf. prej 0,68,00 ha, ZK Dobrevë e Epërme, gjë të cilën të paditurit obligohen që t’ia njohin si dhe të e lejojnë regjistrimin e paluajtshmërisë, pra të regjistrohet në cilësinë e pronarit, udhëzohet Zyra Kadastrale e Komunës së Fushë Kosovës, që paluajtshmërinë nga paragrafi I i këtij aktgjykimi, t’a regjistrojnë në emër të paditësit – ndërhyrësit, si dhe të obligohen të paditurit që paditësit – ndërhyrësit, t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe se kësaj parashtrese ia ka bashkagjitur, kopjen e kontratës së shitëblerjes së patundëshmërisë së dt.05.08.1994 të lidhur në njërën anë, M M N, si shitës dhe në anën tjetër, A Z B nga D e P e Komunës së Fushë Kosovës, si blerës i patundëshmërive përkatëse.

Me dt.31.03.2023, Dhoma e Posaçme, me aktvendimin e saj, SCC – 08 – 0232 të dt.31.05.2023, ka pranuar propozimin e personit të tretë, H B nga Fushë Kosova, që si pjesëmarrës në procedure, të jetë ndërhyrës kryesor në këtë çështje juridike kontestimore.

Mirëpo paditësit me dt.12.04.2023, kanë bërë propozim për caktimin e masës së sigurimit e përmes të cilës kanë kërkuar që të aprovohet propozimi i tyre për caktimin e masës së sigurimit dhe që Agjencisë Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, t’ia ndaloj që ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 1,50,42 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf, prej 1,74,59 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 1,86,00 ha, ngast.kad.nr… në sipërf. prej 2,518,80 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 0,29,85 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 0,31,69 ha, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 0,68,00 ha, dhe ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 4,50,85 ha, e të gjitha të evidentuara, ZK Dobrevë e Epërme, që t’i tjetërsojnë, ngarkojnë ose me të cilat në çfardo mënyre t’i disponojnë deri në përfundimin e procedurës kontestimore, i urdhërohet Zyrës Kadastrale që këtë masë t’a regjistroj në evidencën e saj, si dhe iu ndalohet Zyrave kompetente të noterëve në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, që të bëjnë vërtetimin e çfarëdo kontrate e që objekt i të cilave përbëjnë patundëshmëritë si në pikën I të këtij aktvendimi.

Me dt.15.05.2023, DhPGJK-ja, me Urdhrin e saj, SCC- 08 – 0232 të dt.15.05.2023, ka urdhëruar paditësit – propozuesit e sigurimit, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij urdhri, t’a bëjnë pagesën e taksës gjyqësore për propozimin e dt.12.04.2023 për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit në shumën prej 100.00 € (një qind) dhe atë në Zyrën e Financave pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJKS), e me tërheqjen e vërejtjes, se nëse nuk e paguajnë taksën gjyqësore për propozimin e tyre për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, gjykata do t’ua konsideroj si të tërhequr propozimin e tyre, dhe atë përshtatshmërisht në bazë të nenit 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) për konsiderimin e tërhequr të padisë dhe se pas pranimit të këtij Urdhrit të kësaj gjykate, SCC- 08 – 0232 të dt.15.05.2023, dhe atë me dt.29.05.2023, të njëjtët, brenda afatit të dhënë në këtë Urdhër por edhe deri më tani, nuk ka prova se e kanë bërë pagesën e taksës gjyqësore për propozimin e tyre të dt.12.04.2023 për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

2023:073150

Me dt.12.06.2023, DhPGJSK-ja, me aktvendimin e Kolegjit të saj, SCC - 08 – 0232 të dt.12.06.2023, propozimin e paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, ua ka konsideruar të tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Me dt.11.09.2023, paditësit – propozuesit e sigurimit, M, N nga R, dhe M K nga R, N K nga N, dhe S N nga R, që të gjithë nga Republika e Serbisë, kanë paraqitur sërish propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe i kanë propozuzar gjykatë që të aprovohet propozimi i tyre dhe që të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit me seli në Prishtinë, t'ia ndaloj që patundëshmëritë në ngast.kad.nr…. në vendin e quajtur, ''… '', arë e klasës së 3-të, në sipërf, prej 1,74,59 ha, ZK ZK D e E, ngast.kad.nr…. në sipërf. prej 1,86,00 ha, arë e klasës së 3-të, në vendin e quajtur, ''…, ZK D e E, ngast.kad.nr…., në vendin e quajtur, ''…, arë e klasës së 3-të, në sipërf. prej 0,29,85 ha, ZK D e E, ngast.kad.nr…., arë e klasës së 3-të, në vendin e quajtur, ''….'', në sipërfaqe prej 1,31.69 ha, ZK ZK D e E, dhe ngast.kad.nr…., në vendin e quajtur, ''…'', arë e klasës së 3-të, në sipërf. prej 4,50.85 ha, ZK ZK D e E, që t'i tjetërsojnë, ngarkojnë ose me të cilat në çfardo mënyre t'i disponojnë deri në pëfundimin e procedurës kontestimore, i urdhërohet Zyrës Kadastrale që këtë masë t'a regjistroj në evidencën e saj, si dhe iu ndalohet Zyrave kompetente të noterëve në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, që të bëjnë vërtetimin e çfarëdo kontrate e që objekt i të cilave përbëjnë patundëshmëritë si në pikën I të këtij aktvendimi.

Paditësit – propozuesit e sigurimit, propozimi të tyre për caktimin e masës së sigurimit, nuk ia kanë bashkangjitur asnjë prove të vetme.

Me dt.05.10.2023, kjo gjykatë me Urdhrin e saj, SCC – 08 – 0232 të dt.05.10.2023, ka urdhëruar të paditurën, që të paraqes përgjigjje në propozimin e paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit dhe se e njëjta me dt.09.10.2023, ka paraqitur përgjigjje në këtë propozim e në të cilën kanë theksuar se paditësit nuk kanë ofruar prova të besueshme nga të cilat vlerësohet se mund të fitojnë të drejtën e pronësisë mbi ngastrat në fjalë për të cilat kërkohet masa e sigurisë, pra nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme se : 1. Egziston e drejta (në këtë rast e pronësisë) dhe 2. Kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë pa riparueshme nëse nuk miratohet kjo kërkesës e tyre apo kjo masë e sigurisë, se ky propozim, nuk përmban arsyetimin të mjaftueshëm dhe të bazuar në fakte të argumetuara, se mos aprovimi i masës së sigurisë, do t'i shkaktonte dëm të pa riparueshëm apo i pa kompensueshëm në mjete monetare dhe i atçastshëm, se sipas nenit 66 par.1 të Ligjit, Nr.06/L – 086 për Dhomën e Posaçme, parashihet se :*''Me kërkesë të palës, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një aktvendim për aprovim të Urdhrit paraprak (masë të përkohshme) nëse pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimi janë të drejtëpërdrejta dhe të pariparueshme, si dhe do të kenë pasoja për palën nëse nuk lëshohet aktvendimi për aprovimin e masës së sigurisë''*, se paditësit me provat e prezentuara, nuk e kanë bërë të besueshme kërkesën për aprovimin e maës sës sigurisë, dhe i kanë propozuar gjykatës që të merr aktvendim e me të cilën, hedhet poshtë ose refuzohet në tërësi si i bazuar në ligj propozimi i propozuesve, M N nga R dhe M K nga R etj për aprovimin e masës së sigurisë në ngast.kad.nr…. me sipërfaqe prej

1,74,59 ha, ngast.kad.nr…. në sipërfaqe prej 1,86,00 ha, ngast.kad.nr…. në sipërfaqe prej 02,85,00 ha dhe ngast.kad.nr…. në sipërfaqe prej 0,31,69 ha, e të gjitha ara të kl. së 3-të e që gjinden në vendin e quajtur,''…..''të evidentuara, ZK ZK D e E, dhe ngas.kad.nr…. me sipërfaqe

2023:073150

prej 4,50.85 ha, arë e kl. së 5-të që gjendjen në të njëjtin vend dhe Zonë Kadastrale, ZK D e E si dhe obligohen paditësit, që t'i paguajnë shpenzimet procedurale që të krijohen deri në fund të këtij kontesti dhe se kësaj përgjigjje, ia ka bashkangjitur provat siç janë : marrëveshja për shitjen, Nr.596/2006 të dt.01 nëntor 2006 dhe deklaratës së transferit, Nr.596/2006 të dt.01 nëntor 2006 (në gjuhën angleze) për shitjen të lidhur në mes AKP-së dhe N.P.''V I I'' SH.P.K dhe transferin e patundëshmërisë prej KBI, ''Lavërtaria – Blegtoria'', D e E tek NEWCO, ''Lavërtaria – Blegtoria''L.L.C si dhe Fletën Poseduese të dt.02.08.2006 për ngasrat gjegjëse kadastrale të lëshuar nga Komuna e Fushë Kosovës - Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.

Me dt.10.10.2023, DhPGJSK-ja, si gjykatë, paditësve – propozuesve të sigurimit, dhe me dt.20.10.2023, ndërhyrësit kryesor, me Urdhrat e saj, C – III. – 23 – 0232 të dt.10.10.2023, ua ka dërguar Përgjigjjen e të padituës – kundërshtarës së sigurimit të paraqitur në propozimin e paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit.

Me dt.18.10.2023, paditësit, i janë drejtuar kësaj gjykate me parashtresën e dt.18.10.2023 e me të cilën e kanë bërë rregullimin dhe precizimin e padisë në kuptimin subjektiv të saj e së cilës ia kanë bashkangjitur provat gjegjëse siç janë: aktvendimi, O.716/22 të dt.3.6.2022 i Gjykatës Themelore në Rumë, Republika e Serbisë për shpalljen e trashëgimtarëve të paditësit, M N ish nga R si dhe Aktvendimin, Numër, UPP – 315 /2020 të dt.25.03.2022 të noterit, B J – Ç nga R për çështjen e masës së tragjëgimisë së trashëgimlënëses, S N e lindjes Sh nga R, Republika e Serbisë dhe për shpalljen e trashëgimtarëve të saj.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 61 par.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim.

Pas shqyrtimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundimin se propozimi i ndërhyrësve kryesor - propozuesve të sigurimit, M, N nga R, dhe M K nga R, N K nga Nishi, dhe S N nga R, që të gjithë nga Republika e Serbisë për caktimin e masës së sigurimit, **është i pabazuar;**

Sipas nenit 61 par.1 të Ligjit, Nr.06/L – 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mund të nxjerr një masë të sigurisë me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet *i pa riparueshëm* vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar derisa edhe sipas nenit 61 par.2 të Ligjit për DhPGJSK-në, (Ligji nr. 06/L-086) (tani e tutje: LDHP), Dhoma e Posaçme, mund të nxjerrë një

2023:073150

vendim lidhur me propozimin për caktimin e masës e sigurimit pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim.

Paditësit - propozuesit e sigurimit, propozimin për caktimin e masës së sigurimit, e kanë bërë duke u bazuar në dispozitat e nenit 297, 300 dhe nenit 301 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe se gjykata vendosi që propozimin e tyre, do t'a trajtoj në bazë të dispozitave të Ligjit, Nr.06/L – 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për Dhomën e Posaçme), i cili është ligj i veçantë që e rregullon këtë çështje e me pretendimin se procedura vazhdon që nga viti 2008, se në rrjedhën e deritanishe të procedurës, paditësit kanë vërtetuar në mënyrë të padiskutueshme të drejtën e tyre mbi pronën në fjalë dhe kanë paraqitur në gjykatë prova të pa kundërshtueshme të së drejtës së pronësisë (aktvendimin për kthimin e tokave, fletën poseduese, kopjen e planit etj), duke qenë se ekziston frika se i padituri mund të disponoj me pronën në fjalë në cilën mënyrë do t'a vështirësonte ndjeshëm ushtrimin e të drejtave të paditësve, e duke menduar se kushtet nga neni 297, 300 dhe nenit 301 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), për caktimin e masës së sigurisë, janë plotësuar. Mirëpo palët, në rastin konkret, paditësit – propozuesit e sigurimit, pra duhet të ofrojnë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të menjëhershëm dhe të pariparueshëm financiarisht nëse nuk miratohet propozimi i tyre për caktimin e masës së sigurimit e këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet kurse barra e provave bie mbi paditësit – propozuesit e sigurimit.

Për të përcaktuar kushtet paraprake rreth miratimit të masës së sigurimit, paditësit - propozuesit e sigurimit, janë bazuar në atë se ekziston frika se i padturi mund të disponoj me pronën në fjalë në cilën mënyrë do t'a vështirësonte ndjeshëm ushtrimin e të drejtave të paditësve, e duke menduar se kushtet nga neni 297, 300 dhe nenit 301 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), kushtet për caktimin e masës së sigurisë, janë plotësuar por se këtij propozimi, edhe pse nuk i kanë bashkangjitur provat e lartëcekura, këto prova janë pjesë e shkresave të lëndës mirëpo edhe përkundër këtyre provave e veçmas faktin se pronat e ngastrave gjegjëse kadastrale e për të cilat nga paditësit – propozuesit të sigurimit, është kërkuar caktimi i masës së sigurisë, pas kryerjes së privatizimit që nga viti 2006, ato veç se janë bartur në emër të personave të tretë, dhe se për këto arsye edhe këtë propozim e bëjnë të pabazuar, andaj pa paragjykuar vendosjen e plotë nga kjo gjykatë në këtë çështje juridike kontestimore lidhur mbi padinë e paditësve dhe padinë e ndërhyrësit kryesor të paraqitur kundër paditësve dhe të padituës, gjykata konstaton se në këtë rast propozimi i paditësve - propozuesve të sigurimit, M, N nga R, dhe M K nga R, N K nga Nishi, dhe S N nga R, që të gjithë nga Republika e Serbisë për caktimin e masës së sigurimit lidhur me patundshmëritë në ngastrat kadastrale gjegjëse, nuk i plotëson kriteret ligjore ashtu siç parashihen sipas nenit 61 par.1 të Ligjit për DHPGJS-së për caktimin e masës së sigurimit, dhe se si të tillë, këtë propozim për caktimin e masës së sigurimit, edhe e refuzoj si të pabazuar.

Shpenzimet procedurale

Paditësit – propozuesit e sigurimit, kanë bërë pagesën e taksën gjyqësore për propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe atë në shumën prej 100,00 eurove, dhe se për këtë arsye, gjykata nuk do të caktoj shpenzime tjera procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

2023:073150

Prandaj, nga të gjitha arsyet e thëna më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9, 61 par.1 dhe nenit 77 të Ligjit, nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
2023:073149, 23.10.2023

Agron J. Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Diellza Hoxha, Gjykatëse _____

Shkelzen Sylaj, Gjykatës _____

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, mund të parashtrohet ankesë me shkrim për Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe atë në afatin prej **15 (pesë mbëdhjete) ditëve** nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.